

KËRKESË ANKIMORE

çjtuar: Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS)
në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Adresa: Rruga " Ibrahim Rugova", Ndërtesa nr.4: Tiranë



ora, 12:50

ANKUESI	L.Z.H. K	
LZHK	Adresa, posta elektronike dhe/ose nr. I telefonit	
Korrigjimin e		
OBJEKTI I ANKIMIT	Kumotërimit i vendimit 173 i komisionerit	
1.Kërkesë për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në:		
QV nr __, QV nr. ____, QV nr. ____, etj	Njësia Zgjedhore Bashkia _____	
2.Kundërshtimi i Vendimit të KZAZ/ KSHZ		
Vendimi	Titulli i Vendimit	
Nr.	Datë	
___	___/___/___	
3. Kundërshtimi mos veprimit të KZAZ/ KSHZ		
Bazuar në nenin 21, 123/1, 124, 124/1 dhe 126, neni 160, pika 2 dhe 3, neni 161, pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar		
PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR		

Kërkesë ankimore



L.Z.H.K

Felician Topollari

Partia LZHK, regjistruar si parti politike me vendimin e Gjykatës së Tiranës nr 3225, date 17.07.2002, ka paraqitur kërkesen e saj për tu regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të 14.05.2023 në KQZ me shkresën nr prot 1312, dt 03.03.2023.

Pjesë e kërkesës për regjistrimin e subjektit politik ishte i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga ligji për regjistrimin e partise politike në zgjedhjet vendore të 14.05.2023, konkretisht kërkesën për regjistrim që përmbante

1. Vertetimin e gjykatës
2. Emri mbiemri i kryetarit të partise si personi përgjegjës për dorezimin e kandidateve
3. Emri zyrtar i partise politike
4. Perfaqësuesi i partise përpara KQZ
5. Financierja e partise
6. Deklarata Solemne e kryetarit të partise që do të shmang praktikën korruptive dhe të paligjshme në procesin zgjedhor.....

Sipas kërkesave të Kodit Zgjedhor, konkretisht nenit 64/2 të tij ku kërkohej që në kërkesën për regjistrim si subjekt zgjedhor Partia Politike të paraqesi të dhënat e saja, ndër të tjera edhe emrin zyrtar të partise, në këtë kërkesë në kemi paraqitur si emër zyrtar emrin "Aleanca Progresiste LZHK". Emër ky që nuk përputhet me emrin e partise në vertetimin e regjistrimit të Gjykatës së Tiranës të datës 24.02.2023 ku si emër i partisë figuron "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar". Kjo për shkak se në bazë të vendimeve të organeve vendimarrëse të partisë të dt 16.02.2023, partia e ka ndryshuar emrin e saj zyrtar nga "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar", në emrin "Aleanca Progresiste LZHK" që në 16.02.2023. Këtë vendim e kemi depozituar për regjistrim në regjistrin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë më 02.03.2023, dhe sic figuron dhe nga vërtetimi bashkëlidhur i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo çështje po gjykohej nga gjyqtarja Blerina Muca.

Kryekomisioneri ka vendosur në mbledhjen e datës 14.05.2023 të regjistrojë partinë në zgjedhje si subjekt zgjedhor por me emrin e vertetimit të gjykatës dhe jo sipas emrit zyrtar që ka kërkuar partia në kërkesën e saj për regjistrim. Këtë vendim në e kundërshtojmë si të pabazuar në fakte dhe prova dhe kërkojmë nga KAS të korrigjojë vendimin e komisionerit dhe të regjistrojë partinë politike në zgjedhjet e 14 majit 2023 me emrin e saj zyrtar që është "Aleanca Progresiste LZHK", kjo sepse:



Kërkesë ankimore




Nënshkrimi i Ankuesit

Në bazë të statutit të Partisë dhe ligjit në fuqi, emri zyrtar i partisë konsiderohet i ndryshuar që në ditën e vendimarrjes së tij, pra më datë 16.02.2023. Regjistrimi i ndryshimit të emrit në regjistrin e partive politike është një veprim procedural regjistrimi i vendimit, i cili nuk ana e tij nuk afekton vendimin e partisë në këto rast për të ndryshuar emrin e saj zyrtar. Vendimi i ndryshimit të emrit jep efektet në momentin e hyrjes në fuqi dhe jo në momentin e regjistrimit në regjister.

Kjo është arsyeja që Kodi Zgjedhor në nenin 64/2 të tij kërkon përveç vertetimit të regjistrimit të partisë politike në regjistrin e Gjykatës së Tiranës, edhe deklarimin e emrit zyrtar të partisë. Për shkak se mund të ndodhë që emri i vertetimit të gjykatës të jetë i ndryshëm nga emri i partisë për shkak se nuk është reflektuar ende në regjister.

Neni 64/2 i Kodit Zgjedhor kërkon vertetimin e regjistrimit të partisë në Gjykatën e Tiranës vetëm për të provuar personalitetin juridik të subjektit zgjedhor, por jo për të përcaktuar emrin e partisë politike. Këto të drejta e kanë vetëm organet e partisë, të cilat në këto rast kanë marrë vendim për ndryshimin e emrit të partisë nga "Levizja për Zhvillim Kombëtar" në "Aleanca Progresiste LZHK" që në datë 16.02.2023 dhe kanë kërkuar që kjo parti të regjistrohet si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të 14.05.2023 me kërkesën nr 1312 prot të datës 03.03.2023 me emrin e saj zyrtar në fuqi.

Duke pasur parasysh edhe se në bazë të nenit 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, cilido ka të drejtë të mbrojë dhe kërkojë ndreqjen e të dhënave të veta personale, si dhe faktin që emri me të cilin partia ju prezantohet zgjedhësve është jo vetëm zgjedhje e vetë partisë politike, por në asnjë rast nuk çënon interesin e garës elektorale apo interesin e ndonjë prej subjekteve të tjera elektorale në garën e 14 majit 2023, kërkojmë nga ju ndryshimin e vendimit të komisionerit dhe regjistrimin e partisë si subjekt zgjedhor me emrin "Aleanca Progresiste LZHK".



